



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore
Instituti për mjedisin jetësorë dhe shëndetin
Programi studimorë: Menaxhimi i mjedisit jetësorë**

STUDIME TË DOKTORATURËS – CIKLI I TRETË

TEZA:

**“NDIKIMI I NDOTJES SË AJRIT NË SHËNDETIN E POPULLATËS NË
TETOVË PËR PERIUdhËN 2014-2016”**

Mentor:

Prof. Dr. Murtezan Ismaili

Kandidat:

Fatmir Emurllai

Tetovë

Deklarata e ndershmërisë

Unë Fatmir Emurllai, student në studimet e ciklit të tretë në Fakultetin e Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore, Instituti i Mjedisit Jetësorë dhe Shëndetit pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, nën përgjegjësi morale dhe ligjore deklaroj që ky punim doktore është rezultat i punës sime hulumtuese dhe asnjë pjesë e tij nuk është marrë nga autorët tjerë, në përjashtim të pjesëve që janë të regjistruara me referencat përkatëse.

Tetovë

Fatmir Emurllai

Komisioni vlerësues

**Prof. Dr. Mentor Hamiti, kryetar
Universiteti i Evropës Juglindore**

**Prof. Dr. Alba Dumi, anëtare
Universiteti i Biznesit Tiranë**

**Prof. Dr. Sadudin Ibraimi, anëtar
Universiteti i Evropës Juglindore**

**Emeritus. Prof. Dr. Murtezan Ismaili, anëtar - mentor
Universiteti i Evropës Juglindore**

**Prof. Assoc. Dr. Mile Srbinovski, anëtar
Universiteti “Nëna Terezë”**

ABSTRAKT	6
1 Hyrje.....	13
1.1 Qëllimi i studimit.....	14
1.2 Hipoteza kryesore	15
1.3 Hipotezat ndihmëse	15
1.4 Metodatat e hulumtimit.....	15
1.5 Kontributi i prititur shkencorë i hulumtimit të propozuar	16
1.6 Arsyetimi i temës	16
2 KAPITULLI I - NDOTJA E MJEDISIT JETËSORË SI PROBLEM GLOBAL	19
2.1 Historiku i ndotjes së ambientit jetësorë	19
2.2 Problemet e mjedisit jetësorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	28
2.3 Tetova, rajoni në të cilën realizohet hulumtimi – karakteristikat e përgjithshme.....	29
2.3.1 Kuadri ligjorë	32
2.3.2 Mbrojtja shëndetësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut	33
2.3.3 Obligimet dhe kompetencat e Komunës së Tetovës për mjedisin jetësorë	34
2.3.4 Leje ekologjike e integruar	35
2.4 Dioksidi i sulfurit si ndotës i ajrit - SO ₂	36
2.5 Dioksidi i azotit si ndotës i ajrit – NO ₂	37
2.6 Monoksidi i karbonit si ndotës i ajrit – CO	39
2.7 Ozoni si ndotës i ajrit - O ₃	41
2.8 Grimcat PM 10 si ndotës i ajrit.....	43
3 KAPITULLI II - NDOTJA E AJRIT NË QYTETIN E TETOVËS	46
3.1 Mesatarja ditore për SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për periudhën 2014 – 2016.....	47
3.2 Mesatarja mujore për SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për vitin 2014.....	61
3.3 Mesatarja mujore për SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për vitin 2015.....	62
3.4 Mesatarja mujore për SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për vitin 2016.....	63
3.5 Mesatarja e SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për tremujorët e vitit 2014	64
3.6 Mesatarja e SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për tremujorët e vitit 2015	69
3.7 Mesatarja e SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për tremujorët e vitit 2016	74
3.8 Mesatarja vjetore e SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për vitin 2014	79
3.9 Mesatarja vjetore e SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për vitin 2015	80
3.10 Mesatarja vjetore e SO ₂ , NO ₂ , PM ₁₀ , CO, O ₃ për vitin 2016	81

3.11	Burimet e ndotjes së ajrit	84
3.12	Struktura e mjeteve të komunikacionit në regjionin e Tetovës	84
3.13	Mbeturinat komunale të krijuara, të paraqitura në ton	86
3.14	Numri i amvisërive dhe energjentët e harxhuar	87
4	KAPITULLI III - NDIKIMI I NDOTJES SË AJRIT NË SHËNDETIN PUBLIK.....	90
4.1	Klasifikimi ndërkombëtare i sëmundjeve dhe kodimi.....	90
4.2	NDOTJA E AJRIT DHE SHËNDETI	91
4.3	Sëmundjet e rrugëve të frymëmarjes dhe mushkërive.....	100
4.4	Sëmundjet malinje të sistemit respiratorë.....	105
4.5	Sëmundjet kardiovaskulare	113
4.6	Sëmundjet e sistemit cerebrovaskularë	116
5	KAPITULLI IV - LIDHJA NDËRMJET NDOTJES SË AJRIT DHE SËMUNDJEVE	119
5.1	Numri i kontrolleve mjekësore për vitin 2014 dhe analiza	119
5.2	Numri i kontrolleve mjekësore për vitin 2015 dhe analiza	123
5.3	Numri i kontrolleve mjekësore për vitin 2016 dhe analiza	133
5.4	Korrelacioni ndërmjet ndotjes dhe sëmundjeve për vitin 2015	143
5.5	Korrelacioni ndërmjet ndotjes dhe sëmundjeve për vitin 2016	153
5.6	Paraqitja tabelare dhe grafike e rritjes dhe uljes së frekuencës së kontrolleve mjekësore në raport me ndotjen e ajrit	159
6	KAPITULLI V - SHPALOSJA E REZULTATEVE DHE ANALIZA NGA OPINIONI PUBLIK.....	168
6.1	Përcaktimi i opinionit publik të qytetarëve për ndotjen e ajrit në Tetovë.....	168
6.2	Rezultatet e anketimit.....	170
6.3	Përfundimi	193
6.4	Analiza e rezultateve	193
6.5	Konkluzione	198
6.6	Analiza e rrezultateve nga pyetësi.....	199
6.7	Rekomandimet.....	200
7	Bibliografia.....	202

ABSTRAKT

Të hulumtosh ndotjen e ajrit ambiental dhe ndikimin që ka ndotja në shëndetin e popullatës në qytetin ku jetojmë në të njëjtën kohë është kënaqësi, nder, por mbi të gjitha përgjegjësi.

Ajri është elementeti jetik për njeriun dhe veprimtarinë e tij.

Njerëzit vazhdimisht janë të ekspozuar ndaj ndotjes së ajrit nëpërmjet thithjes së ndotësve që gjenden në ajër, konsumit të ujit të pijshëm të ndotur, ekspozimit ndaj tokave të ndotura ose mbetjeve industriale ose konsumit të ushqimeve të ndotura.

Ndotja e ajrit vazhdon të dëmtojë shëndetin e përgjithshëm të njerëzve dhe ul cilësinë e jetës dhe jetëgjatësinë. Kjo ka gjithashtu ndikim të konsiderueshem për rritjen e kostove për kujdesin mjekësorë dhe për shkak të mungesave në punë për arsye shëndetësore redukton edhe produktivitetin e gjithë ekonomisë.

Monitorimi i cilësisë së ajrit mund të kryhet duke matur substancat ndotëse direkt në ajër ose në deponime. Studimet mbi ndotjet atmosferike kanë qenë në mënyrë të vazhdueshme të kufizuara nga kostot e larta të metodave analitike klasike, si dhe nga vështirësitë në kryerjen e monitorimit të gjerë në kohë dhe hapësirë. Megjithatë, ne do të referohemi metodave direkte të matjeve, metoda që na japin rezultate të drejtpërdrejta dhe të sakta pa humbur kohë. Gjatë hulumtimit të këtij disertacioni të doktoratës do të marim të dhënat nga monitorimi i cilësisë së ajrit në rajonin e Tetovës, nga Qendra Informative e Maqedonisë së Veriut për mjedisin jetësorë për periudhën 2014-2016 nga matja e këtyre parametrave, SO₂, CO, NO₂, i O₃, PM 10 të gjitha këto duke u matur në njësi matëse (µg/m³). Nga ana tjetër të dhënat e sëmundjeve që sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë janë të lidhura me ndotjen e ajrit të marra nga Ministria e Shëndetësisë, sektori për shëndetësi elektronike janë përpunuar në baza të përfaqësimit me theks të veçantë sëmundjet respiratore dhe nxjerja e rezultatit me anë të koeficientit të korelacionit duke nxjerrë lidhshmërinë ndërmjet ndotjes dhe sëmundjeve.

Këtë që u tha më lartë jam munduar ta zbërthej përmes disa kapitujve edhe atë në kapitullin e parë hulumtimi ka të bëjë me historikun e ndotjes globale në përgjithësi duke përfshirë këtu edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në kapitullin e dytë analizohet me vemendje të veçantë

ndotja e ajrit në qytetin e Tetovës duke nxjerrë mesataret e ndotjes, ndotësit dhe periudhat kritike të ndotjes. Në pjesën e tretë analizohen sëmundjet me theks të veçantë ato respiratore dhe frekuencën e tyre. Në pjesën e katërt është analizuar lidhja apo korelacioni ndërmjet nivelit të ndotjes së ajrit dhe sëmundjeve respiratore duke nxjerrë rezultatin e koeficientit të korelacionit. Në pjesën e fundit kemi shpalosur rezultatet e anketës me qytetarët e Tetovës rreth opinionit të tyre për gjendjen e cilësisë së ajrit dhe ndikimin në shëndetin tyre. Shpresojmë që me anë të këtyre rezultateve të kësaj teme doktorature të kemi arritur në nivele të kënaqëshme të vërtetojmë ndikimin e ndotjes së ajrit ambiental në shëndetin publik.

Fjalë kyçe: Ajri, shëndeti publik, ndotja, sëmundjet respiratore

АБСТРАКТ

Да го истражуваш загадувањето на амбиенталниот воздух и влијанието што загадувањето го има врз здравјето на населението во градот во кое живееме истовремено е задоволство, чест, но пред се одговорност.

Воздухот е од витално значење за човекот и неговата активност.

Луѓето постојано се изложени на загадување на воздухот преку апсорпција на загадувачи што се наоѓаат во воздухот, конзумирање на загадена вода за пиење, изложеност на загадена почва или индустриски отпад или конзумирање на загадена храна.

Загадувањето на воздухот продолжува да му наштетува на целокупното здравје на луѓето и го намалува квалитетот на животот и долговечноста. Ова исто така има значително влијание врз зголемувањето на трошоците за медицинска нега и поради недостатокот на работа од здравствени причини, исто така, ја намалува продуктивноста на целата економија.

Следењето на квалитетот на воздухот може да се изврши со мерење на загадувачите директно во воздухот или во депозитите. Студиите за атмосферско загадување биле секогаш ограничени поради високите трошоци на класичните аналитички методи, како и од тешкотиите при спроведување на широк опсег на мониторинг во време и простор. Сепак, ние ќе се осврнеме на методите за директно мерење, методи кои ни даваат директни и точни резултати без губење на време. За време на истражувањето на оваа докторска дисертација ќе добиеме податоци од мониторинг на квалитетот на воздухот во тетовскиот регион, од Информативниот Центар на Северна Македонија за животната средина за периодот 2014-2016 година од мерења за овие параметри SO_2 , CO , NO_2 , O_3 , PM_{10} , сите овие измерени во единици за мерење ($\mu g/m^3$). Од друга страна, податоците за болестите кои според Светската здравствена организација се поврзани со загадувањето на воздухот земени од Министерството за здравство, секторот за електронско здравство се изработени врз база на застапеност, со посебен акцент на респираторните заболувања и

вадење на резултатот од страна на коефициентот на корелација, извлекувајќи ја корелацијата помеѓу загадувањето и болестите. Ова што беше кажано погоре, сум се обидува да го образложам преку неколкуте поглавја, и тоа во првото поглавје истражувањето се однесува на историјата на глобалното загадување, вклучително и Република Северна Македонија. Во второто поглавје, се анализира со посебно внимание загадувањето на воздухот во градот Тетово, вадејќи го просекот на загадување, загадувачите и критични периоди на загадување. Во третиот дел, се анализираат болестите со посебен акцент на респираторните и нивната фреквенција. Во четвртиот дел е анализирано односот или корелацијата помеѓу нивото на загадениот воздух и респираторните заболувања вадејќи го резултатот на коефициентот на корелација. Во последниот дел, ги објавуваме резултатите од истражувањето на анкетата со граѓаните на Тетово за нивното мислење за состојбата со квалитетот на воздухот и влијанието врз нивното здравје. Се надеваме дека преку овие резултати на оваа докторска теза дека достигнавме на задоволително ниво да го докажеме влијанието на загадувањето на воздухот врз јавното здравје.

Клучни зборови: Воздух, јавно здравје, загадување, респираторни заболувања

ABSTRACT

To explore ambient air pollution and the impact that pollution has on the health of the population in the city where we live at the same time is a pleasure, an honor, but above all a responsibility.

Air is the vital element for man and his activity.

People are constantly exposed to air pollution through the absorption of pollutants found in the air, consumption of polluted drinking water, exposure to contaminated land or industrial waste, or consumption of contaminated food.

Air pollution continues to harm people's overall health and reduces quality of life and longevity. This also has a significant impact on increasing costs for medical care and due to absenteeism for health reasons also reduces the productivity of the entire economy.

Air quality monitoring can be performed by measuring pollutants directly in the air or in landfills. Studies on air pollution have been consistently constrained by the high costs of classical analytical methods, as well as by the difficulties in conducting extensive monitoring in time and space. However, we will refer to direct measurement methods, methods that give us direct and accurate results without wasting time. During the research of this doctoral dissertation we will take data from the air quality monitoring in the Tetovo region, from the Environmental Information Center of Northern Macedonia for the period 2014-2016 from the measurement of these parameters, SO₂, CO, NO₂, i O₃, PM 10 all these being measured in units of measurement ($\mu\text{g} / \text{m}^3$). On the other hand, the data of diseases that according to the World Health Organization are related to air pollution received from the Ministry of Health, The e-health sector has been elaborated on the basis of the emphasis on the representation of respiratory diseases and the derivation of the result by means of the correlation coefficient, deriving the connection between pollution and diseases.

I have tried to break down what was said above through several chapters, and in the first chapter the research has to do with the history of global pollution in general, including the Republic of Northern Macedonia. The second chapter analyzes with special attention the air pollution in the

city of Tetova by deriving the averages of pollution, pollutants and critical periods of pollution. The third part analyzes the diseases with special emphasis on respiratory diseases and their frequency. In the fourth part, the connection or correlation between the level of air pollution and respiratory diseases is analyzed, deriving the result of the correlation coefficient. In the last part we have disclosed the results of the survey with the citizens of Tetovo about their opinion on the state of air quality and the impact on their health. We hope that through these results of this doctoral thesis we have reached satisfactory levels to prove the impact of environmental air pollution on public health.

Keywords: Air, public health, pollution, respiratory diseases

Përmbajtje e shkurtër

Kapitulli I: Ndotja e mjedisit jetësorë si problem global

Kapitulli II: Ndotja e ajrit në qytetin e Tetovës

Kapitulli III: Ndikimi i ndotjes së ajrit në shëndetin publik

Kapitulli IV: Lidhja ndërmjet ndotjes së ajrit dhe sëmundjeve

Kapitulli V: Shpalosja e rezultateve dhe analiza nga opinioni publik

1 Hyrje

Ndotja e ajrit përbën sipas Agjensisë Evropiane të Mjedisit (EEA) “rezikun më të madh shëndetësorë të varur prej mjedisit në Evropë”. Ndotja e ajrit u shkurton jetën njerëzve. Përveç kësaj, ajo favorizon sëmundje të rënda të zemrës, të rrugëve të frymëmarrjes dhe kancerin.

Në një raport të ri të publikuar për konferencën e klimës në Paris nga EEA në Kopenhagë, vlerësohet se 430,000 vdekje të parakohshme në vit në Evropë lidhen me ndotjen e ajrit. Ndotja e ajrit është një prej problemeve më serioze në botë. Ajo ka të bëjë me futjen (emetimin) në atmosferë të substancave ndotëse të cilat ndikojnë në shëndetin e njerëzve dhe në mjedis. Atmosfera përbën një nga rrugët më të rëndësishme të shpërndarjes së substancave ndotëse në mjedis. Distanca e transportit të substancave ndotëse në atmosferë mund të jetë disa qindra deri mijëra kilometra. Kjo bën që ndotjet atmosferike të kenë shpesh herë karakter rajonal madje edhe karakter global. Këta ndotës emitohen nga burime të ndryshme dhe disa prej tyre veprojnë mes tyre për të formuar komponime të reja në ajër. Kur kemi parasysh që, metalet e rënda janë elemente që nuk mund të zbërthehen, atëherë këto metale do të vazhdojnë të qëndrojnë në mjedis. Ndryshe nga shumë ndotës organikë të cilët përfundimisht degradojnë në dioksid karboni dhe ujë, metalet e rënda do tentojnë të akumulohen në mjedis, veçanërisht në liqene, në grykëderdhje ose në sedimentet detare. Këto metale mund të transportohen nga një pjesë e mjedisit në tjetrin. Shkarkimet që bëhen nga metalet e rënda në mjedis janë një problem global, pasi ata janë një kërcënim gjithnjë e në rritje për mjedisin në përgjithësi. Si burime natyrore të ndotjes nga metalet e rënda në përgjithësi konsiderohen grimcat e dheut që ngrihen nga era, vullkanet, erozioni i shkëmbinjve, djegia e pyjeve. Kjo nënkupton që njerëzimi është bërë faktori kyç në ciklin rajonal dhe global të tyre. Burimi kryesor i emetimit të metaleve të rënda janë veçanërisht minierat. Burime të tjera të emetimit të metaleve të rënda janë fabrikat dhe uzinat metalurgjike, nënproduktet e djegies, shkarkimet industriale, bujqësore dhe urbane, pesticidet që përmbajnë metale të rënda dhe trafiku. Pas marrjes (grumbullimit) të rezultateve nga matjet e bëra në regjionin e Tetovës, do të nxjerrim konkluzionet e këtij disertacioni të doktoratës dhe do të bëjmë diskutimin e rezultateve të punimit.

Qyteti i Tetovës si qendër e madhe dhe e rëndësishme e Maqedonisë së Veriut duhet të ketë një planifikim zhvillimor urban modern dhe efikas, duke u bazuar në normat dhe standardet evropiane dhe të cilat përfshihen në një plan zhvillimor urban, dhe në këtë plan duhet të parashihen edhe masat mbrojtëse kundër ndotjes së ajrit dhe mjedisit në përgjithësi.

Natyrisht që, edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duhet të hartojë ligje të mirëfillta për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me direktivat dhe standardet evropiane, të hartojë projekte për vetëdijesimin e qytetarëve, të shtojë kontrollet dhe të marrë masa konkrete ndaj ndotësve kryesor të ajrit dhe mjedisit.

1.1 Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesorë i këtij hulumtimi është që të përaktojmë se a ndikon në mënyrë të ndjeshme ajri ambiental që e marin nëpërmjet frymëmarrjes qytetarët e Tetovës në shëndetin e tyre.

Nga ky qëllim i vendosur kështu, rrjedhin nën qëllimet në vazhdim:

1. Përcaktimi i cilësisë së ajrit ambiental në Tetovë. I njëjti do të bëhet në bazë të të dhënave zyrtare për cilësinë e ajrit të matura nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinorë. Këto të dhëna pastaj do të përpunohen në mënyrë të përshtatshme për aritjen e qëllimit të këtij hulumtimi. Rezultatet do të paraqiten për mesataren e çdo dite për tre vitet e hulumtimit, mesatarja për çdo muaj, secilin tremujorësh dhe për çdo vit për periudhën e hulumtimit (2014-2016). Në këtë mënyrë akcenti do të vendoset në përcaktimin e periudhave kritike të vitit në aspekt të cilësisë së ajrit në qytetin e Tetovës. Kualiteti i ajrit do të përcaktohet në bazë të këtyre parametrave: PM10, SO₂, CO₂, NO₂, O₃.

2. Përcaktimi i përfaqësimit të sëmundjeve respiratore të lidhura me cilësinë e ajrit, të qytetarëve të Tetovës. Për aritjen e këtij qëllimi do të përdoren të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, në bazë të asaj se egziston obligim ligjorë për të gjithë organizatat shëndetësore të përcjellin të dhënat për sëmundjet. Të dhënat do të përpunohen në përputhje me qëllimet e vendosura për këtë hulumtim. Për përcaktim të besueshëm të ndikimit të kualitetit të ajrit në shëndetin e njerëzve,

parasysh do të meren vetëm sëmundjet të cilët sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë lidhen direkt me ndotjen e ajrit.

3. Përcaktimi i ndërlidhjes korelative ndërmjet ndotjes së ajrit dhe sëmundjeve respiratore.

4. Përcaktimi i opinionit publik të qytetarëve për ndotjen e ajrit në Tetovë, si dhe mënyrat për përmirësimin e tij. Kjo do të bëhet në bazë të anketës nga një numër reprezentativ të qytetarëve nga sektorë të ndryshëm, si qeveritarë ashtu edhe joqeveritarë. E gjithë kjo në fund do të përdoret për përgatitjen e propozim masave për përmirësimin e kualitetit të ajrit në këtë qytet.

1.2 Hipoteza kryesore

Në kuadër të kësaj tezë të disertacionit hipoteza bazë do të trajtohet:

- Cilësia e ajrit ambiental në qytetin e Tetovës ndjeshëm ndikon në shëndetin e qytetarëve.

1.3 Hipotezat ndihmëse

- Koncentrimi i grimcave PM10 ka ndikim të ndjeshëm në shëndetin e qytetarëve.
- Koncentrimet e SO₂, CO₂, NO₂, O₃, kanë ndikim të dukshëm në shëndetin e qytetarëve.
- Vlerat matëse të substancave ndotëse dhe sëmundjet e sistemit respiratorë janë në korrelacion permanent.
- Vetëdija e qytetarëve për ndotjen e ajrit ambiental nuk është në nivelin e duhur.

1.4 Metodatat e hulumtimit

Në hulumtim do të përdoren metodat joeksperimentale (metoda e analizës teorike dhe sinteza), qasja transverzale, instrumenti fletë anketimi i cili do të përgatitet për këtë hulumtim. Në hulumtim do të përdoren më shumë procedura statistikore: mesatarja aritmetike, frekuencë përqindëshe, koeficient i korelacionit etj.

1.5 Kontributi i pritur shkencorë i hulumtimit të propozuar

Duke pasur parasysh gjendjen momentale të ndotjes së ajrit në Maqedoninë e Veriut dhe rajon, kontributi shkencor i këtij hulumtimi do të jetë i konsiderueshëm. Natyrisht që ky hulumtim shkencorë do të jetë i rëndësie të veçantë, sepse hulumtimi do të bëhet në territorin e Tetovës. Kur kemi parasysh se Tetova është qendër e madhe dhe e rëndësishme e Maqedonisë së Veriut dhe qendra më e madhe urbane në regjionin veriperëndimorë, dhe historikisht ka luajtur rol gjeopolitikë dhe gjeostrategjik në Gadishullin Ballkanik, kontributi shkencor i këtij hulumtimi do të jetë shumë i mirëpritur dhe me vlerë për qytetarët e vendit tonë. Në përgjithësi Maqedonia e Veriut si shtet në tranzicion ka përjetuar sfida të mëdha. Një prej sfidave më kryesore ka qenë edhe ndotja e ajrit, sepse subjektet e prodhimeve industriale, por edhe automjetet e transportit rrugor si dhe amvisëritë, nuk kanë respektuar asnjë kriter të ndotjes së ajrit. Gjithashtu e rëndësie të veçantë është respektimi i kriterëve nga ana e kapaciteteve industriale që marin pjesë në ndotjen e ajrit. Këtu duhet të theksohet edhe përdorimi pa kriter të lëndëve djegëse në amvisëri dhe objekte tjera biznesi.

Kontributi shkencorë konsiston me faktin se ky punim do të paraqesë një kontribut të rëndësishëm në sferën e mbrojtjes së ambientit jetësorë si për Republikën e Maqedonisë së Veriut ashtu edhe më gjerë. Kontributi praktik i punimit konsiston me faktin se ky punim do të ju ndihmojë qytetarëve të informohen reth ndotjes së ajrit dhe ndikimin që ka ndotja në shëndetin e tyre në mjedise ku ata jetojnë dhe veprojnë si dhe senzibilizimin e tyre për rëndësinë e një mjedisi të pastër ku do të jetojnë gjenerata më të shëndosha me një perspektivë më të mirë për ardhmërinë e tyre.

1.6 Arsyetimi i temës

Ndotja e ajrit në përgjithësi në Maqedoninë e Veriut është e ndryshme në regjione të ndryshme varësisht nga koncentrimi i objekteve industriale, dendësia e popullates, numri i automjeteve, përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje si dhe vetëdija dhe kultura me theks të veçantë por njëkohësisht edhe regjionet urbane dhe rurale. Megjithatë, Tetova si qendër urbane ndër më të mëdhajat, i ka të gjitha predispozitat për të qenë mjedisi ndër më të ndoturit në Maqedoninë e

Veriut, kur kemi parasysh që, qytetin e Tetovës e karakterizon një trafik mjaft i dendur me numër të madh makinash, që brenda ditës qarkullojnë edhe nga gjithë regjioni i pollogut, me vende jo të mjaftueshme për parking dhe makina të vjetra, që drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen e ajrit dhe në shëndetin e popullatës.

Cilësia e ajrit në Tetovë nga 2014 deri në vitin 2016, është vlerësuar si vizualisht, përmes shqisave të frymëmarrjes poashtu edhe përmes matjeve të parametrave nga monitorimet.

Gjatë punimit të disertacionit të doktoratës, do të mbledhim të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit përmes aparaturave që janë përdorur (matjet nga institucionet relevante për periudhën e cekur) duke i krahasuar (analizuar) rezultatet me matjet në këtë periudhë të hulumtimit. Duke bërë analizën e hulumtimit të matjeve në territorin e Tetovës, së pari do të bëjmë identifikim e ndotësve të mjedisit, pastaj do të bëjmë vlerësimin dhe diskutimet e gjendjes nga ndotja e mjedisit, përkatësisht ndotja e ajrit, duke paraqitur tejkalimet e parametrave matës si dhe njëkohësisht marjen (mbledhjen) e të dhënave nga institucionet shëndetësore dhe shtetërore rreth impaktit që mund të ketë ndotja e ajrit në shëndetin e popullatës në qytetin e Tetovës.

KAPITULLI

I

NDOTJA E MJEDISIT JETËSORË SI PROBLEM GLOBAL

1. HISTORIKU I NDOTJES SË AMBIENTIT JETËSORË
2. PROBLEMET E MJEDISIT JETËSORË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT
3. TETOVA- RAJONI NË TË CILIN REALIZOHET HULUMTITMI – KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME
4. DIOKSIDI I SULFURIT
5. DIOKSIDI I AZOTIT
6. MONOKSIDI I KARBONIT
7. OZONI
8. GRIMCAT PM10

2 KAPITULLI I - NDOTJA E MJEDISIT JETËSORË SI PROBLEM GLOBAL

Ambient jetësorë është kuptim shumë i gjërë dhe paraqet hapësirën, në të cilën jetojmë: shtëpia jonë, vendi ku punojmë, vendi për mësim dhe lojë për fëmijët tanë, si dhe rrethina e tërësishme, vendbanimet dhe e tërë natyra që na rrethon. Ambienti jetësorë nuk u takon vetëm njerëzve, por tërë botës së gjallë, duke i përfshirë të gjithë kafshët dhe bimët.

2.1 Historiku i ndotjes së ambientit jetësorë

Çfarëdo prishje e balancit të krijuar nga natyra ka si rezultat pasojat të cilat nganjëherë mund të jenë dhe të paparashikueshme bile edhe fatale. Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës drejtëpërsëdrejti ndikojnë në balancin e sipërpërmendur. Trendi i ndotjes së ambientit jetësorë, që është i inicuar nga procesi i industrializimit dhe i globalizimit, krijon efekte globale, prej të cilëve aktualisht më i rëndësishëm është efekti i ndryshimit të klimës. Këto efekte globale ndikojnë në mënyrë serioze mbi jetën e të gjithë njerëzve në të gjitha shtetet dhe bashkësitë, sepse ndotja e ambientit jetësorë nuk njihet kufij administrativë. Ndotja zakonisht mund të definohet edhe si diçka që njerëzit e prodhojnë në sasira të mëdha e që ndikon negativisht në shëndetin ose mirëqenien tonë. Janë dy faktorë që ndikojnë në masën e dëmtimeve nga ndotësit: sasia e ndotësve dhe zhvillimi i teknologjisë që gjen forma të reja të ndotjes. Ndonjëherë mjedisi mund të jetë aq i ndotur sa që edhe me intervenimin e njeriut, një hapësirë e caktuar nuk mund të revitalizohet për një kohë të shkurtër (Ismaili, 2006).

Një kohë të gjatë është menduar se ajri gjendet në sasira të pakufishme. Por me zhvillimin e hovshëm të shoqërive moderne u paraqitën edhe paralajmërimet e para. Në atmosferë filluan çdo ditë të hudhen me mijëra materie të ndryshme. Koncentrimi i tyre shpesh ka pasojat të dëmshme mbi shëndetin e njeriut, mjedisin jetësorë dhe të mirat materiale. Me termin emetim të materjeve të dëmshme në atmosferë nënkuptohet lëshimi i çfarëdo lloj materie nga ndonjë proces apo njësi me të cilën ajo ndot. Ajri ndotet nga gazrat dhe materiet e forta. Ndotësit para së gjithash kanë ndikim të dëmshëm mbi organizmat e gjallë (Srbinovski, 1996).

Në shoqëritë e hershme, djegia dhe ngrohja e drurit luanin një rol kryesor në zhvillimin e ndotjes së ajrit, i cili atëherë kufizohej kryesisht në ndotjen e hapësirave të brendshme (Brimblecombe & Makra, 2015).

Qytetet e hershme u krijuan në zona të vogla; nga ana tjetër, dendësia e popullsisë së tyre ishte e lartë. Ky banim i dendur siguroi një mjet më të mirë për mbrojtjen dhe lehtësimin e lëvizjes së njerëzve dhe transportimin e mallrave brenda kufijve të qyteteve. Në rrethana të tilla, tymi nga farkëtarët, dhe pajisjet e tjera prodhuese që kërkonin energji, grumbulloheshin midis shtëpive (Brimblecombe & Makra, 2015). Në pjesën e fundit të shekullit XIII, në një përpjekje për të zvogëluar ndotjen e ajrit, mbreti i Anglisë Edward I kërcënoi Londinezët me dënime të ashpra nëse nuk ndalonin së djeguri qymyrgurin. Nga fundi i shekullit të 18-të dhe pjesa e parë e shekullit të 19-të, qymyri hyri në përdorim në shkallë të gjerë gjatë Revolucionit Industrial. Smogu dhe bloza që rezultoi kishte ndikime serioze shëndetësore tek banorët e qendrave urbane në rritje. Shiu acid, i zbuluar për herë të parë në vitet 1850, ishte një problem tjetër që rridhte nga përdorimi i qymyrgurit. Në Smogun e Madh të vitit 1952, ndotësit nga fabrikat dhe vatrat e shtëpive të përziera me kondensimin e ajrit vranë të paktën 4,000 njerëz në Londër gjatë disa ditëve.

Disa vjet më parë, në 1948, ndotja e rëndë e ajrit industrial krijoi një smog vdekjeprurës që asfiksoi 20 vetë në Donora, Pensilvani, dhe shkaktoi 7000 të tjerë të sëmurë. Lëshimi i squfurit dhe komponimeve të azotit të prodhuara nga njeriu në atmosferë ndikuan negativisht në bimë, peshqi, tokë, pyje dhe disa materiale ndërtimi (Editors, 2009).

Revolucioni Industrial solli një infuzion të kimikateve dhe mbetjeve të patrajuara në rrjedhat lokale që shërbenin si furnizim me ujë. Ishte Revolucioni Industrial që lindi ndotjen e mjedisit siç e njohim sot. Shfaqja e fabrikave të mëdha dhe konsumimi i sasive të jashtëzakonshme të qymyrit shkaktuan ndotje të paparë të ajrit dhe vëllimi i madh i shkarkimeve kimike industriale shtoi ngarkesën në rritje të mbeturinave të patrajuara të njeriut. Ndotja e mjedisit jetesore po bëhet një problem global, më i rëndë në qendrat urbane, por sidoqoftë duke kontaminuar edhe territore të mëdha, larg qyteteve. Dëshmia në rritje e ndotjes lokale dhe globale dhe një publik gjithnjë e më shumë i informuar me kalimin e kohës kanë dhënë shkas për ambientalizmin dhe lëvizjen mjedisore, të cilat në përgjithësi kërkojnë të kufizojnë ndikimin e njeriut në mjedis (Wikipedia, 2021).

Shqyrtoni një situatë kur ka shumë kimikate organike sintetike të pranishëm në një mostër uji ose toke. Supozoni se secila është e pranishme vetëm në një nivel të vogël, një nivel që pak do ta

konsideronin një rrezik. Disa janë të shqetësuar për efektet shtesë të mundshme; domethënë, nëse një numër i kimikateve ushtrojnë efekte biologjike me mjete të ngjashme, atëherë, nëse nivelet e të gjitha kimikateve shtohen së bashku, totali mund të shkaktojë efekte të dëmshme. Më keq, efekti mund të jetë sinergjik; domethënë, një kimikate mund të zmadhojë efektin e një tjetri. Të tjerë kundërshtojnë që ekzistojnë gjithashtu mijëra kimikate natyrale të pranishëm në ujë, tokë dhe ushqim, shumë prej të cilave janë të ngjashme, ose identike, me kimikatet antropogjenike. Ata më tej theksojnë se trupi i kafshëve nuk mund të tregojë nëse një kimikate vjen nga një burim natyre apo nga një burim njerëzor. Një kualifikim i kësaj deklarate të fundit është se njerëzit, kafshët dhe shumica e mikroorganizmave degradojnë disa kimikate të poliklorinuar ekstremisht ngadalë. Agjencia e Shteteve të Bashkuara për mbrojtjen e mjedisit (EPA) raporton se amerikanët shpenzojnë 140 miliardë në vit për të kontrolluar dhe pastruar ndotjen. Deri në vitin 2000, pajtueshmëria me rregulloren e mjedisit do të kushtojë rreth 160 miliardë në vit, 2.8% të Prodhimit Kombëtar Bruto. Një ndotës sipas përcaktimit prodhon efekte mjedisore të padëshiruara. Kështu, kimikatet natyrore mund të jenë gjithashtu ndotës. Konsideroni sasi të mëdha të hirit, klorit, dioksidit të squfurit dhe kimikateve të tjera të lëshuara gjatë shpërthimit vullkanik. Ose merrni parasysh radonin kimik radioaktiv, i cili është i përhapur në mjedis nga burimet natyrore. Radoni është i lidhur me kancerin e mushkërive të njeriut, dhe EPA e rendit atë të dytin vetëm të tymi i duhanit si një rrezik për shëndetin mjedisor. Nivelet e radonit në ajrin e jashtëm janë mjaft të ulëta sa nuk konsiderohet ndotës. Që një kimikate të ketë një efekt, së pari duhet të kontaktojë trupin. Duhet të ketë ekspozim. Një kimikat zakonisht ka tre rrugë të mundshme të hyrjes në trup: inhalimi në mushkëri, gëlltitje në traktin gastrointestinal ose absorbin në të gjithë lëkurën. Disa kimikate janë toksike vetëm nga një rrugë hyrje. Formaldehidi është një kancerogjen vetëm nëse inhalohet. Radoni është gjithashtu kryesisht një kancerogjen nga inhalimi. Arseniku është toksik nga të tre rrugët: thithja e lëkurës, gëlltitja dhe inhalimi (Hill, 1997).

Format më të hershme të ndotjes antropogjene ka të ngjarë të datojnë shumë në parahistori, duke ndodhur në vendbanimet ku ujërat e zeza dhe uji i pijshëm nuk ishin të ndara në mënyrë adekuate. Ndotja e ajrit ka të ngjarë të ketë një histori të gjatë gjithashtu, pa dyshim që daton nga përdorimi më i hershëm i zjarrit. Një moment historik shumë më i vonshëm ka të ngjarë të ketë qenë zhvillimi i punimit të metaleve në kohërat e lashta, kur teknikat primitive të nxjerrjes dhe shkrirjes mund të kene krijuar në mënyrë konceptuale probleme të lokalizuara të cilësisë së dobët

të ajrit dhe ndoshta ndotjes së ujit. Ligjet më të hershme kundër ndotjes me shumë gjasë u miratuan për mbrojtjen e cilësisë së ujit, në kohërat romake për shembull, dhe në kohërat mesjetare u vendos ndalimi në frenimin e qymyrit me cilësi të dobët në Londër. Ndotja lind kryesisht nga shqetësimi njerëzor i cikleve elementare natyrore dhe transferimi i elementeve dhe komponimeve të tyre në pjesë të mjedisit fizik ku ata normalisht do të gjendeshin në përqendrim më të ulët ose, në disa raste, aspak. Në shumicën e rasteve kjo kërkon nxjerrjen e elementeve nga korja e Tokës, me nxjerrjen e mineraleve dhe karburanteve fosile, e ndjekur nga përdorimi i këtyre lëndëve të para në prodhimin e mallrave, të materialeve ose sigurimin e energjisë. Bujqësia moderne varet kryesisht nga përdorimi i pesticideve dhe plehrave për të minimizuar dëmtimin e të korrave dhe për të synuar rendimentin maksimal. Ndotja ndodh kur këto kimikate janë larë ose nëpër toka në ujërat sipërfaqësorë dhe në ujërat nëntokësorë. Një tjetër ndikim i ndotjes lind nga djegia e biomasës, përfshirë zonat pyjore, me qëllim pastrimin e tokës për përdorim bujqësor; ndikimet lindin kryesisht nga ndotja e ajrit nga grimcat dhe nga hyrja e dherave të gërryera nga toka e pastruar në rrjedhat ujore. Kërkesa e madhe për energji e bujqësisë moderne, përfshirë prodhimin e kimikateve bujqësore, është një burim i mëtejshëm i ndotjes. Pjesa më e madhe e energjisë, për përdorim shtëpiak dhe industrial, prodhohet nga djegia e karburanteve fosile, e cila gjeneron emetime atmosferike të oksideve të CO_x, NO_x, dhe SO_x, së bashku me lëndë grimcash të imëta, disa prej të cilave përmbajnë sasi gjurmësh të elementëve toksikë. Shkaterimi mikrobik i mbetjeve organike në mjedisin me oksigjen të ulët të depozitave gjeneron metan dhe lende të tjera që mund të shpërndahen në atmosferë. Nëse uji i shiut depërton përmes mbeturinave të depozituara në tokë, rrjedhjet mund të formojnë, transportojnë potencialisht metale dhe ndotës të tjerë në ujërat nëntokësorë (Rieuwerts, 2015).

Një faktor kontribues në degradimin e mjedisit në botë është rezultati i mbipopullimit. Sa serioz është ndikimi i mbipopullimit në mjedisin e Tokës ?. Me rritjen e shpejtë të popullsisë, ndotja është problem i rritjes së proporcioneve. Për të fituar perspektivën mbi problemin e mbipopullimit, le të hedhim një vështrim në te dhenat. Nga rreth 2 miliardë në 1960 dhe rreth 3 miliardë në 1995, popullsia e botës është rritur me shpejtësi në nivelin e saj aktual prej afro 6 miliardë dhe duke u rritur. Popullsia e botës rritet me më shumë se 80-90 milion çdo vit dhe parashikohet të arrijë në 10 miliardë deri në vitin 2025, përveç nëse ndodh një rritje e konsiderueshme nga kontrolli i lindjes në të gjithë botën. Së bashku me rritjen e shpejtë të rritjes së popullsisë, është një trend i shoqëruar me presionin e popullatës: përqendrimet e popullsisë.

Këto përqendrimet e popullsisë kanë tendencë të përkeqësojnë problemet e ndotjes duke rritur nivelin e ndotjes dhe degradimin shoqëruar të mjedisit me rritjen e shpyllëzimeve, shkretëzimin dhe erozionin e tokës. Jo vetëm që përqendrimet e popullsisë rritin ndotjen, por ato gjithashtu ndryshojnë natyrën e problemit duke prodhuar ndotës që bëhen të rrezikshëm për shkak të sasive të mëdha të përfshira, siç është rasti me të gjitha llojet e mbeturinave komunale. Në dekadat e fundit, përqendrimi i popullatës brenda rajoneve të ndryshme të botës ka demonstruar një dinamizëm të caktuar, një prirje drejt ndryshimit gjithnjë e më të shpejtë. Ky problem është më i dukshëm në vendet në zhvillim, ato që jo vetëm që kanë rritje të shpejtë të popullsisë së përgjithshme, por gjithashtu kanë një popullsi të madhe që janë joshur nga mundësitë ekonomike për në zonat më të ngjeshura. Këto zona të ngjeshura zakonisht janë përgjegjëse për konsumimin e më shumë burimeve natyrore sesa zonat rurale dhe prodhojnë male me produkte të mbeturinave. Jo vetëm që prodhohet më shumë mbeturina për frymë sesa në zonat rurale, por në zonat urbane, këto mbeturina janë gjithashtu më të rrezikshme. Kjo shkakton tensione në infrastrukturën e qytetit, duke rritur kërkesën në aftësinë e qytetit për të thithur dhe trajtuar mbeturinat. Presioni shkon duke u rritur gjithashtu tek banorët jorurbanë (sektori agrar) për të prodhuar më shumë ushqime në më pak tokë, duke tensionuar produktivitetin e tokës dhe përkeqësuar problemin e ndotjes bujqësore. Shumë vende të industrializuara kanë përjetuar industrializim për më shumë se një shekull dhe, më e rëndësishmja, kanë ndier edhe efektet e ndotjes për një periudhë më të gjatë kohore (Spellman, 1999).

Gama dhe burimet e ndotësve të ajrit janë pothuajse të pakufizuara, siç janë shqetësimet e publikut për to. Ndikimi në shëndet ka qenë i larmishëm. Në fillim, shqetësimi serioz okupoi emetimet lokale të dioksidit të squfurit dhe burimet e grimcave, kryesisht ato vendase. Sidoqoftë, pasi këto filluan të kontrollohen, shqetësimi përqendrohet në grimcat dhe oksidet e azotit nga automjetet motorike. Mësimi kryesor për menaxherin e ndotjes duket se problemet e reja të ndotjes së ajrit lindin sa më shpejt që zgjidhen problemet e vjetra. Ndërsa shembujt e mësipërm janë shqetësim kombëtar dhe global, menaxheri i ndotjes gjithashtu duhet të pranojë që çështjet lokale të ndotjes së ajrit gjithashtu mund të jenë serioze. Burimet individuale të emetimeve toksike mund të kërcënojnë komunitetet lokale, ose telashi mund të shkaktohet nga pluhuri nga një gurorë. Ndotësit e konsideruar përfshijnë amoniakun, monoksidin e karbonit, fluoridet, metalet e rënda, oksidet e azotit, ozonin, grimcat, dioksidin e squfurit, përbërjen organike të paqëndrueshme dhe shiun acid. Vëzhgimi i burimeve të emetimeve mund të bëhet ose në bazë të

ndotësve individualë ose burimeve individuale. Automjetet motorike, për shembull, lëshojnë një koktej me oksidet e azotit, monoksidin e karbonit, komponimet organike të paqëndrueshme, grimcat, metalet e rënda dhe (për dizelin) dioksidin e squfuri. Amoniaku prodhohet nga disa procese industriale, por burimi më i madh është bujqësia. Intensifikimi i prodhimit të kafshëve dhe përdorimi në rritje i plehrave ka shkaktuar një rritje të madhe të emetimeve në vitin e fundit. Emetimet nga kafshët ndodhin nga azoti i pashfrytëzuar i sekretuar në mbeturinat e tyre. Këto emisione mund të ndodhin kur prodhohen mbeturina, ose gjatë ruajtjes ose përhapjes së tyre në fusha. Emetimet gjithashtu mund të ndodhin nga fushat ku aplikohen plehra të tepërta të azotit. Ky problem i fundit është gjithashtu një shkak i depërtimit të nitrateve në ujërat nëntokësorë dhe është një problem serioz i ndotjes së ujit. Oksidet e azotit prodhohen nga djegia e të gjitha karburanteve fosile, nga qymyri dhe termocentrali me gaz, deri tek automjetet motorike. Disa nga azotet mund të vijnë nga vetë karburanti. Megjithatë, shumica e saj vjen nga reagimi i azotit atmosferik dhe oksigjenit brenda dhomës së djegies. Një numër i madh i metaleve janë toksike për bimët dhe kafshët. Shumë prej tyre ndodhin natyrshëm në përqendrime të ndryshme, për shkak të prurjeve të shkëmbinjeve dhe tokës dhe aktivitetit vullkanik. Sidoqoftë, aktiviteti njerëzor mund të rezultojë në emisione të mëdha shtesë. Shumica e operacioneve të përpunimit të metaleve do të lëshojnë sasi të ndryshme të metaleve, siç pritet (Farmer, 1997).

Të jesh i shëndetshëm nënkupton mungesën e sëmundjeve dhe zgjatjen e jetës. Mirëqenia fizike varet gjithashtu nga cilësia e jetës dhe të qenit i shëndetshëm. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh) pranë OKB-së, shëndeti përkufizohet si "gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale dhe jo thjesht mungesa e sëmundjes". Në fakt, shëndeti është aftësia për të funksionuar në mënyrë efektive brenda një mjedisi të caktuar. Shëndeti i mirë përfshin procesin e përshtatjes së vazhdueshme ndaj ndryshimeve në mjedisin fizik, biologjik dhe shoqëror. Prandaj, është e rëndësishme të kujdesemi për "shëndetin e mjedisit". Nëse mjedisi është i shëndetshëm, edhe qeniet njerëzore do të jenë të shëndetshme. Masat themelore që mund të merren për ta mbajtur mjedisin të shëndetshëm janë si më poshtë: Mirëmbajtja e një ambienti të pastër, kontrolli i sëmundjes ngjithëse, diagnostikimi i hershëm dhe parandalimi i sëmundjeve, vetëdijësimi për higjienën personale, zhvillimi i një makinerie sociale për të përmirësuar standardin e jetës. Mjedisi ka një ndikim të thellë në shëndet, dhe elemente të tilla si ajri, uji dhe ushqimi janë thelbësore për mbijetesën e qenies njerëzore. Përveç disponueshmërisë së tyre, duhet të sigurohet edhe cilësia e tyre. Progresi në industrializim ka rritur rreziqet mjedisore dhe

ka rezultuar në ndotje të ajrit, ujit, zhurmës dhe rrezatimit, të cilat kanë shkaktuar shumë probleme shëndetësore dhe sëmundje. Krimbat, insektet dhe organizmat e tjerë që lulëzojnë në mjedisin e ndotur bëhen parazitë që shkaktojnë sëmundje, bartës të sëmundjeve dhe shkaktare të ndërmjetëm. Edhe pse nuk është e mundur të zhduken plotësisht agjentët që shkaktojnë sëmundje, masa të ndryshme mund të merren për të parandaluar përhapjen e tyre. Mjedisi fiziologjik ka efekte të caktuara të sëmundjes tek njerëzit. Për shembull, është vërtetuar se kancerogjenët e pranishëm në cigare shkaktojnë kancer të mushkërive. Një numër i substancave kimike janë të pranishme në mjedis, të cilat kanë efekte toksike në organizmat e gjallë. Këto efekte mund të jenë me kohëzgjatje të shkurtër ose me kohëzgjatje të gjatë. Ushqimi është gjithashtu një burim potencial i infeksionit. Mund të ndotet nga mikroorganizmat, toksinat mikrobike dhe jo mikrobiale dhe kimikatet e shtuara. Ai gjithashtu mund të ndotet në çdo pikë gjatë udhëtimit të tij nga prodhuesi te konsumatori. Sipas vlerësimeve të OBSH-së, ambienti me cilësi të dobët kontribuon në rreth 25% të të gjitha problemeve shëndetësore të parandalueshme në botë (Ahluwalia, 2015).

Përreth globit egziston një mbeshtjellës natyral i gaztë, e cila lejon një pjesë të konsiderueshme të rrezatimeve diellore të hyjnë drejt sipërfaqes së tokës, e cila e thith atë dhe rrezaton valë infra të kuqe dhe të nxehtit. Kjo nxehtësi transferohet në shtresat e mësipërme. Ndërsa shtresat e ngrohta ngrihen, ato kalojnë në shtresa më të larta dhe akoma më të larta. Më në fund, shumica e rrezatimeve diellore rrezatohen përsëri në hapësirë si valë infra të kuqe dhe të nxehtit. Sistemi midis globit dhe atmosferës së tij është në një gjendje ekuilibri dinamik. Shkalla e përthithjes së rrezatimeve diellore dhe emetimeve të saj që kthehen në hapësirë si valët infra të kuqe dhe nxehtësie pothuajse ekuilibrojnë njëra-tjetrën. Ato gazra dhe avuj që lejojnë kalimin e lirë në rrezatime me gjatësi relativisht më të shkurtër të valëve ndërsa thithin në mënyrë efektive valët infra të kuqe dhe të nxehtit luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mbajtjen e temperaturave të sipërfaqes brenda një game në të cilën jeta mund të ekzistojë. Këto gazra formojnë një mbeshtjellëse në të gjithë globin, i cili kontrollon kalimin e valëve infra të kuqe dhe të nxehtit nga korja e tokës përsëri në hapësirë dhe e mbajnë atë të ngrohtë dhe mikpritës. Kjo strukturë është pothuajse e ngjashme me atë të serrës në të cilën atmosfera e mbyllur me gotë nxehtet për shkak të izolimit të saj nga pjesa tjetër e mjedisit. Prandaj, ngrohja globale njihet edhe si efekti serë dhe gazrat përgjegjës për të njihen si gazra serë. Ekzistojnë një numër i gazrave të pranishëm në atmosferë të cilat janë të afta të thithin në mënyrë efektive valët e nxehtësisë dhe

rrezet infra të kuqe, ndërsa janë transparente ndaj rrezatimit me gjatësi më të ulët të valëve. Disa nga gazrat e troposferës të cilat hujnë në këtë kategori janë dioksidi i karbonit, metani, oksidet e azotit, dioksidi i sulfurit, ozoni, avujt e ujit dhe klorofluorocarbonet. Është aktiviteti njerëzor i cili është kryesisht përgjegjës për akumulimin e gazrave serë në atmosferë. Prodhimi i energjisë dhe përdorimi i tij në mënyra të ndryshme si përdorimi operacional i pajisjeve elektrike ose elektronike, makineritë e llojeve të ndryshme dhe përdorimi i automobilave, autobusëve, kamionëve, për komunikim në rrugë, praktikat bujqësore intensive, mbajtja e sasive të madhe të bagëtive , përdorimi i gazit të klorofluorokarbureve në frigorifer dhe spërkatës, përdorimi i tokës për kanale, rezervuare uji, pellgje, ndërtimtari dhe përdorimi i bimëve industriale dhe prodhimet e tyre të janë disa nga aspektet e veprimtarive njerëzore të cilat janë përgjegjëse për të prishur ekuilibrin dinamik midis globit dhe atmosferës së tij dhe shkaktojnë efekt ngrohjeje nga përqëndrimi më i lartë i gazrave serë (Shafi, 2005).

Efektet e dëmshme të ndotjes së ajrit mund të ndahen në dy klasa, efekte akute dhe kronike. Efektet akute manifestohen menjëherë pas ekspozimit afatshkurtër ndaj ndotësve të ajrit në përqendrim të lartë, dhe efektet kronike bëhen të dukshme vetëm pas ekspozimit të vazhdueshëm ndaj niveleve të ulëta të ndotjes së ajrit. Efektet kronike janë shumë të vështira për tu demonstruar dhe për pasojë janë më pak të dukshme. Prandaj, shumë nga njohuritë tona për efektet e ndotjes së ajrit të njerëzit vijnë nga studimi i episodeve akute të ndotjes së ajrit. Vdekjet nga këto episode maten duke krahasuar numrin e vdekjeve që shoqërohen normalisht me zonën dhe periudhën në fjalë me ato që ndodhin gjatë episodit. Ndikimi më i madh i ndotjes së ajrit në shëndetin e njeriut, sidoqoftë, rezulton nga ekspozimi i vazhdueshëm ndaj përqendrimit të ulët në kondita të pandryshueshme. Këto janë efekte kronike. Besohet se këto efekte ndodhin përmes acarimit të vazhdueshëm nga ndotësit të cilët bashkëveprojnë me faktorë të tjerë mjedisorë ose biologjikë për të filluar sëmundjen ose intensifikuar sëmundjen e mëparshme ekzistuese. Ekzistojnë dy qasje të përgjithshme për të studiuar efektet kronike. Njëra është epidemiologjike dhe tjetra është toksikologjike. Studimet epidemiologjike janë studime statistikore mbi efektet e ndotjes së ajrit në popullatën njerëzore në kushte natyrore. Studime të tilla janë jashtëzakonisht të rëndësishme, por për shkak të shumëllojshmërisë së faktorëve të panjohur nuk është e mundur të vendosni një marrëdhënie shkak-pasoje. Studimet toksikologjike kryhen në laborator në kushte të kontrolluara. Efektet e disa variableve si përqendrimi i ndotësve, kohëzgjatja e ekspozimit, temperatura, lagështia etj, mund të studiohen në mënyrë eksperimentale. Efekti toksik i grimcave

mund të grupohet në tre kategori: ndërhyrja e grimcave inerte në mekanizmat pastrues të traktit respirator, Grimcat veprojnë si bartës të gazrave toksikë të si SO₂ dhe prodhojnë efekt sinergjik, grimcat mund të jenë thelbësisht toksike për shkak të karakteristikave të tyre fizike ose kimike. Efektet helmuese të plumbit të njerëzit janë njohur prej kohësh. Plumbi është një neurotoksinë helmimi i të cilit rezulton në konvulsione, delirium, gjendje kome, dëmtim të rëndë dhe të pakthyeshem të trurit dhe vdekje. Plumbi i thithur është shumë më serioz se plumbi që gëlltitet. Grimcat e imëta të emetuara nga automobilot mbahen brenda mushkërive dhe thithen nga trupi me një efikasitet prej rreth 40 përqind. Trupi i përgjigjet çdo rritje të marrjes së plumbit duke e ekskretuar atë në urinë sa më shumë që të jetë e mundur dhe pjesa tjetër ruhet parësisht në kocka (Rao, 2006).

Studimet epidemiologjike kanë qenë shumë më informuese në lidhje me efektet shëndetësore si në nivelin individual, ashtu edhe në atë të popullatës, duke studiuar ashtu siç bëjnë, situatën në jetën reale. Vështirësia vjen në vendosjen se sa i madh mund të jetë një efekt dhe për cilin ndotës specifik ose ndotës të perzier një efekt i tillë mund t'i atribuohet. Në baza ditore, ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit mund të ketë një efekt të menjëhershëm, qoftë në të njëjtën ditë me një rritje të ndotjes së ajrit ose ndoshta të vonuar, duke mbetur dy, tre ose më shumë ditë pas një ngritjeje. Në disa situata, ekspozimi kumulativ ose mesatar gjatë një periudhe prej tre ditësh ose më shumë mund të jetë i rëndësishëm në përcaktimin e rezultatit shëndetësor. Nuk ka dyshim se ekziston një varg sensitiviteti ndaj ndotësve nëpër grupe të ndryshme "në rrezik" për sa i përket efekteve shëndetësore të ndotjes së ajrit. Pacienti me sëmundje para-ekzistuese të mushkërive dhe zemrës duket të jetë në rrezik, veçanërisht pacientët me astmë dhe sëmundje kronike abstruktive pulmonare (COPD). Kohët e fundit, janë identifikuar efektet e ndotjes së grimcave tek pacienti me sëmundje koronare të zemrës dhe sëmundje cerebrovaskulare, por roli i ndotësit të gaztë në këto dy kategori sëmundjesh nuk është aq i qartë. Astma është një gjendje e zakonshme, që prek rreth 6% të popullsisë së përgjithshme të Mbreterise se Bashkuar. Për rrjedhojë, këta pacientë janë jo vetëm të rëndësishëm si një grup rreziku për efektet e ndotjes së ajrit, por gjithashtu veprojnë si një grup ku ndryshimet në funksionin e mushkërive janë të shpeshta dhe të matshme kur përpiqen të përcaktojnë praninë dhe madhësinë e një efekti nga një stimul i jashtëm. COPD është në thelb një sëmundje e duhanpirësve të cigareve dhe megjithëse, si astma, është gjithashtu një gjendje inflamatore, në baza ditore këta pacientë nuk tregojnë ndryshime të dukshme në funksionin e mushkërive. Pacientët me COPD ose astmë zhvillojnë simptoma për shkak të

